



## FTESË PËR ADVOKATËSI TË PËRBASHKËT TË RINJTË SHQIPTARË QË LARGOHEN NGA PËRKUJDESI

I/ e Nderuar Zotëri/ Zonjë

SOS Fshatrat e Fëmijëve është një organizatë në shërbim të fëmijëve pa kujdes prindëror apo në rrezik për ta humbur kujdesin prindëror.

Programet kryesore të SOS organizatës janë : SOS Fshati I Fëmijëve; SOS komunitetet rinore në mbështetje të të rinjve pa kujdes prindëror 14-18 vjeç; SOS Projektet e Fuqizimit të Familjes në mbështetje të familjeve që nuk kanë mundësi për tu përkujdesur për fëmijët e tyre.

Në fund të 2008, organizata SOS zhvilloi një studim për situatën e të rinjve që largohen nga përkujdesi. Situata e të rinjve/ fëmijëve që largohen nga institucionet rezidenciale publike në moshën 15 vjeç është vërtet alarmante.

Largimi herët nga përkujdesi (në moshën 15 vjeç) dhe përballja me jetën krejt I vetëm, pa mbështetje nga shteti, pa strehim, kualifikim, arsim, bën që këta të rinj/ fëmijë të mbijetojnë me mundësitë e tyre dhe të jenë shpesh viktimë e rreziqeve të shumëfishta.

Për këtë arsye SOS Fshatrat e Fëmijëve është duke ndërmarrë një fushatë advokatësie për situatën e të rinjve pa kujdes prindëror me moton “UNË VLEJ”. Kjo fushatë do të zhvillohet në kuadër të një projekti tre vjeçar advokues për kushtet dhe të drejtat e të rinjve.

Aktivitetet kryesore për vitin 2009 do të zhvillohen brenda nëntor-dhjetor dhe në vijimësi në 2010-2011.

Ky projekt realizohet me mbështetjen e SOS Kinderdorf International.

**Organizata SOS fton rrjetin e BKTF dhe organizata apo individë të interesuar në një takim të përbashkët për të diskutuar për këtë çështje.**

*Qëllimi i këtij takimi do të jetë njohja me problematikën e të rinjve , inisiativën e SOS në këtë drejtim objektivat e projektit “UNE VLEJ”, diskutimin e përbashkët dhe shqyrtimin e interesit të përbashkët për të mbështetur këtë target grup dhe për të advokuar së bashku.*

Takimi do të zhvillohet të enjten, datë 29 Tetor, ora 14.00 pranë ambjenteve të SOS Fshatit të Fëmijëve.

Pjesëmarrës në këtë takim do të jenë edhe te rinj SOS si dhe të rinj nga organizata rinore të cilët mbështesin këtë çështje.

Kemi besim se të gjithë së bashku mund të sjellim ndryshime në benefit të fëmijëve pa kujdes prindëror.



*SOS Fshatrat e Fëmijëve  
Shqipëri*

---

Zyra Nacionale

Ju lutem, mos hezitoni të na kontaktoni për më shumë informacion,

**Me respekt,**

**Teuta Shkenza,  
Drejtore Nacionale  
SOS Fshatrat e Fëmijëve**